



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:249951
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05485053

PPP.nr.226/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbartimore të kreditorit Telekom i Kosovës sh.a, me seli në Prishtinë, kundër debitorit S.A.T. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, të cilën e përfaqëson av Liman Musa nga Ferizaj, për pagesën e borgjit, duke vendosur për propozimin e të autorizuarit të debitorit, për kthimin në gjendje të mëparshme, me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar propozimi i të autorizuarit të debitorit S.T., për kthim në gjendje të mëparshme, për shfrytëzimin e të drejtës së prapësimit, kundër urdhrin për përmbartim P.nr.366/15, të datës 19.05.2015, i lëshuar nga Përmbartuesi privat I.M.

A r s y e t i m i

Përmbartuesi privat I.M., me urdhrin P.nr.366/15, të datës 19.05.2015, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditorit Telekom i Kosovës sh.a, kundër debitorit S.T., për pagesën e borxhit në shumë prej 80.87 euro, në bazë të faturave : ...4, e datës 07.03.2014, ...4, e datës 03.04.2014, ...4, e datës 04.05.2014, ...4, e datës 05.06.2014, ...4, e datës 04.07.2014, ...4, e datës 05.08.2014, ...4, e datës 03.09.2014, ...4, e datës 02.10.2014 dhe ...4, e datës 02.11.2014.

I autorizuarit i debitorit, më datë 11.11.2022, në zyrën e përmbartuesit privat I.M., ka parashtruar propozim për kthimin në gjendjen e mëparshme të afatit për ushtrimin e të drejtës së prapësimit kundër urdhrin për përmbartim P.nr.366/15, të datës 19.05.2015.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të propozimit të autorizuarit të debitorit si dhe shkresave të lëndës e posaçërisht flet kthesën mbi dorëzimin e urdhrin për përmbartim, ka konstatuar se debitorit propozimi dhe urdhri për përmbartim i janë dorëzuar konform nenit 110, par 1 dhe 2 dhe nenit 111, par 1, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përkatësisht nga shkresat e lëndës vërtetohet se urdhri për përmbartim pas tentimit të parë për dorëzimin e urdhrin për përmbartim debitorit, i është dorëzuar kushëririt të tij Q.T. edhe atë me datën 25.05.2015 dhe kështu

dorëzimi i tillë në këtë mënyrë konsiderohet i rregullt. Për më tepër, në nenin 110, par 1 dhe 2, të LPK-së, është paraparë shprehimisht : *“Në qoftë se personi të cilit duhet dorëzuar personalisht shkresa nuk gjendet atje ku duhet bërë dorëzimi, dorëzuesi do të njoftohet se kur dhe ku do të mund ta gjejë këtë person dhe do t’ia lejë ndonjë personi të theksuar në nenin 111 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji njoftimin me shkrim që për marrjen e shkresës të jetë në ditën dhe në orën e caktuar në banesën e vet, përkatësisht në vendin e vet të punës”, Po që se edhe pas kësaj dorëzuesi i shkresës nuk e gjen personin të cilit duhet dorëzuar shkresa, atëherë ai do të veprojë sipas dispozitave të nenit 111 të këtij ligji, dhe kështu dorëzimi do të konsiderohet i kryer”*. Gjithashtu, në nenin 111, par 1, të LPK-së, është paraparë po ashtu se: *“Po që se personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës nuk gjendet në banesën e vet, dorëzimi bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtar të rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim, e po që se as këta nuk gjenden në banesë, shkresa do t’i jepet fqinjit, po që se pajtohet me një gjë të këtillë. **Dorëzimi i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i vlefshëm”***.

Si përfundim, gjykata duke i marrë parasysh faktet e cekura më lart, konstatoj se në rastin konkret përmbaruesi privat ka vepruar në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 110, par 1 dhe 2, dhe nenit 111, par 1, të LPK-së, dhe se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme përkatësisht vlerësoj se nuk ekzistojnë shkaqet e arsyeshme të cilat nuk mund të parashikohen e as të evitohen, bazuar në nenin 129 par, 1, të LPK-së, për faktin se debitori nuk e ka bërë të besueshme arsyen e lëshimit të afatit për ushtrimin e prapësimin kundër urdhrit për përmbarim të cekur më lartë.

Gjykata aktvendimin e mbështeti në nenin 17, të LPP-së lidhur nenin 110, par dhe 2, 111, par 1 dhe 133, par 4, të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
PPP.nr.226/22, më datë 21.03.2024

Gjyqtari,
Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë në bazë të nenit 133, par 4, të Ligjit për Procedurën Kontestimore.